



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:026996

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05496615

**C.nr.644/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V.**, gjyqtari Alush Sinani, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.J.nga fshati D., Komuna V., i përfaqësuar nga T.A., avokat në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 861.30 €, jashtë seancës, me datë 22.03.2024, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

**I.** Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.J.nga fshati D., Komuna V. dhe detyrohet e paditura Komuna e V.së-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, për 319 ditë të pranisë në punë, për periudhën 22.01.2021-21.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 638 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 223.30 €, të gjitha në shumë të përgjithshme 861.30 €, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

**II.** Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën 125 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**Arsyetim**

Me datë 18.01.2023, përfaqësuesi i paditësit, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 861.30 €.

Në padi, ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën "Bafti Haxhiu" në V. andaj, nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit për 319 ditë të pranisë në punë, për periudhën 22.01.2021-21.11.2022, t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 638 € dhe shpenzimet e udhëtimit në shumën 223.30 €, të gjitha në shumë të përgjithshme 861.30 €. Si prova, padisë i ka bashkëngjitur: Vërtetimin e lëshuar nga shkolla "Bafti Haxhiu", nr. 208/23, të datës 10.10.2023 dhe Listën e pagave EM00018918. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, shumën 21 € për taksën gjyqësore për padi dhe shumën 104 € për përpilimin e padisë.

E paditura, me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se nuk është përgjegjëse për detyrimet nga Kontrata Kolektive e V.t 2017 pasi pagat dhe mëditjet paguhen nga ministria përkatëse e poashtu, tutje ka pretenduar se Qeveria dhe Ministria e Arsimit e kanë shfuqizuar Kontratën Kolektive (tutje KK) të SBASHK-ut, nr. 105, të datës 22.01.2021 si dhe KK paraprake nr. 01B/2056, të datës 21.11.2022 prandaj edhe nuk rrjedh asnjë obligim për të paditurën ndaj paditësit. Lidhur me shpenzimet procedurale, nuk është deklaruar.

Gjykata ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës si dhe fakti se paditësi ka qenë e pranishme në punë 319 ditë dhe se gjatë kësaj periudhe kohore ka udhëtuar në relacionin D.-V. dhe anasjelltas, pasi e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Gjykata ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin është përcaktuar se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë” dhe ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit.

Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, lidhur me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK-së), të datës 18.04.2017 dhe KKAK-së të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim” dhe par. 5 të të njëjtit nen, i cili përcakton se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili ka përcaktuar: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është 8 % (tetë përqind) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në

Numri i lëndës:

2024:026996

Datë:

25.03.2024

Numri i dokumentit:

05496615

sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Gjithashtu, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditësit edhe atë, për taksën gjyqësore për padi shumë 21 € dhe për përpilimin e padisë shumë prej 104 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**

**C.nr.644/2024, Datë 22.03.2024**

**Gjyqtari,**  
Alush Sinani

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.